



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.2.2023

Nr: 54

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 24 JANAR – 2 SHKURT 2023**

Sot, më datë 10.2.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Portual Durrës, Bashkia Dibër, Bashkia Elbasan, Bashkia Finiq, Bashkia Kamëz, Bashkia Kavajë, Bashkia Kukës, Bashkia Lushnjë, Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Kryeministria, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, Ministrisa e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisa e Drejtësisë, Ministris e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisa e Kulturës, Ministrisa e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prefekti i Qarkut Korçë, Prefekti i Qarkut Lezhë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të organeve publike për periudhën 24 janar deri më 2 shkurt 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19 pikat 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Data: 10.2.2023 Nr: 54
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 24 janar - 2 shkurt 2023”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 24 janar deri më 2 shkurt 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 324 aktivitete, nga 52 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se 109 aktivitete të zhvilluara nga 30 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 4.2.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 8.2.2023, ora 11:00. Palët e interesuara depozituan pranë KQZ pretendimet e tyre si vijon;

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,
 - Aktivitet “Ndergjegjësuës/Informues”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, krijoi bindjen se tematikat e aktiviteteve të raportuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, përbëjnë veprimtari me karakter administrativ në përmbushje të funksioneve të vetë institucionit.

2. Autoriteti Portual Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet “Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes Joint-Venture për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Marinës Turistike dhe Ballinës Ujore të Durrësit, mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Eagle Hills SHPK, Albanian Seaports Development Company sh.a dhe Nishmi Lld.”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,

Autoriteti Portual Durrës, nëpërmjet email-it të datës 8.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se *“Autoriteti Portual Durrës nuk është palë e nënshkrimit të marrëveshjes Joint-Venture për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Marinës Turistike dhe Ballinës Ujore të Durrësit, por palë pjesëmarrëse në veprimtari. Gjithashtu veprimtaria nuk*

ishte e planifikuar paraprakisht dhe menjëherë sapo kemi marrë njoftimin kemi përmbushur detyrimin për raportim”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Autoriteti Portual Durrës, pavarësisht faktit që ka kryer raportimin, duke qenë në cilësinë e institucionit të ftuar ka qenë në pamundësi për të respektuar afatit ligjor të raportimit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. Bashkia Dibër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktivitet “Marrje vendimesh”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Bashkia Dibër, nëpërmjet email-it të datës 9.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“aktiviteti i raportuar në datën 26.01.2023 për organizimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak në datë 30.01.2023, është një gabim nga ana jonë pasi mbledhja ishte parashikuar dhe është zhvilluar në datë 31.01.2023. Kjo vërtetohet edhe nëpërmjet vendimit që ka marrë Këshilli Bashkiak në datë 31.01.2023.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura nga palët vlerësoi se moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkaku që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati. Mbledhjet e këshillit bashkiak në vetvete përbën veprimtari administrative.

4. Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
- Aktivitet “Ftesë nga Drejtori I DPSHTR z. Blendi Gonxhe”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Bashkia Elbasan nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për raportimin e parë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkaku që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Bashkia Elbasan ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë.

Për raportimin e dytë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Bashkia Elbasan nuk ka patur mundësi të raportoje për këtë aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Bashkia Finiq ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Dhënie titull nderi”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023.

Bashkia Finiq, nëpërmjet email- it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“kanë kryer me vonesë raportimin për shkak të problemeve me kredencialet për të hyrë në sistem. Për këtë kanë komunikuar me KQZ dhe kanë dërguar edhe email, ku kanë raportuar për veprimtarinë edhe pse jo me të dhëna të plota. Sapo është rregulluar sistemi, kanë kryer raportimin në formën e duhur.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në periudhën e shqyrtimit.

6. Bashkia Kamëz ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

Data: 10.2.2023 Nr: 54
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 24 janar - 2 shkurt 2023”

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.1.2023.

Bashkia Kamëz, nëpërmjet email- it të datës 7.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Raportimin e kanë kryer në datë 30.01.2023 dhe për shkak të një lapsusi kanë shënuar datën e zhvillimit të aktivitetit datë 05.01.2023 (duhet të ishte 05.02.2023).”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin apo lapsuset në hedhjen e të dhënave kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

7. Bashkia Kavajë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 28.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023.

Bashkia Kavajë, nëpërmjet shkresës nr. 526 prot., datë 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“data është shënuar gabimisht nga ana e jonë por aktiviteti është zhvilluar 3 ditë më pas. Nuk është pasqyruara sepse sistemi nuk lejonte që të kryheshin ndryshime.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura krijoi bindjen se, aktiviteti është zhvilluar tre ditë më pas dhe vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë nuk kanë ardhur pasojat e saj.

8. Bashkia Kukës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktivitet “Vizitë/takim me pensionist të qendrës”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023,
- Aktivitet “Takim delegacioni”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Bashkia Kukës, nëpërmjet email- it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“në këto aktivitete kanë qenë në cilësinë e të ftuarit dhe në këto kushte nuk kishin mundësi të shtynin datën e aktivitetit. Gjithashtu pretendojnë që sapo u vendosën në dispozicion kredencialet kanë bërë raportimin.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Bashkia Kukës nuk ka patur mundësinë të përmbushë afatin ligjor për raportimin e këtij aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për aktivitetin e tretë të raportuar, nga sa konstatohet në ndërfaqe, veprimtaria është në përmbushje të detyrave funksionale, pa pjesëmarrjen e publikut apo të medias. Në këto kushte nuk mund të sanksionohet mosrespektimi i afatit për këtë lloj veprimtarie.

9. Bashkia Lushnjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 9 (nëntë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
2. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
3. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
4. Aktivitet “Ndergjegjësues/Informues”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
5. Aktivitet “Inagurim”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
6. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
7. Aktivitet “Takim joformal”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
8. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
9. Aktivitet “Takim joformal”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023.

Bashkia Lushnjë, nëpërmjet shkresës nr. 1064 prot., datë 7.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“për dy aktivitete kanë kryer gabim llogaritjen e ditëve duke përfshirë ditën e zhvillimit të aktivitetit. Për një aktivitet pretendojnë se janë në cilësinë e të ftuarit. Për pesë prej aktiviteteve aktiviteteteve pretendon se ka pasur probleme*

me sistemin për shkak se ishin ditët e fillimit. Për një aktivitet pretendojnë se nuk është realizuar por është shtyrë data e zhvillimit të tij.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se për aktivitetet 1, 6 të raportuara, vonesat kanë ardhur për shkak të problematikave me sistemin, të cilat kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për aktivitetet 2,3, 8 dhe 9 vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Bashkia Lushnjë ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për aktivitetin 5 të raportuar vlerëson se, Bashkia Lushnjë ka qenë në pamundësi për të respektuar afatin ligjor për raportimin e këtij aktiviteti, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për aktivitetin 7, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, aktiviteti është shtyrë dhe është zhvilluar disa ditë më pas brenda afatit ligjor. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa shkelja nuk është konsoliduar dhe nuk kanë ardhur pasojat e saj.

Në përfundim të hetimit për Bashkinë Lushnjë, për aktivitetet 8 dhe 9 më lart, konstatohet se këto veprimtari kanë si tematikë dhe pjesëmarrje një target grup të caktuar dhe nuk janë me pjesëmarrjen e medias apo të kenë si qëllim informimin e publikut rreth këtij aktiviteti. Nga sa informacion jepet në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

10. Bashkia Prrenjas ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktivitet ndergjegjesues/informues”, raportuar në datë 1.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.2.2023.

Bashkia Përrenjas, nëpërmjet shkresës nr. 411 prot., datë 7.2.2023, dhe email-it të datës 7.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“Ilogaria e tyre në sistem nga KQZ është përfunduar në datë 30.01.2023 dhe konfirmimi i takimit nga të rinjtë që janë në shkolla/universitete është bërë në datë 01.02.2023. Për këtë arsye nuk ka mjaftuar koha për raportimin në afat.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Digjitalizim shërbimesh”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet shkresës nr. 1737/1 prot., datë 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“pretendon për pamundësinë e hyrjes në sistem si rrjedhojë e problemit të sistemit elektronik dhe kjo ka sjellë pamundësinë për të raportuar aktivitetin brenda afatit. Pretendojnë se kanë dërguar shkresë pranë KQZ për “vënie në dijeni mbi pamundësinë e logimit”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

12. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuesi i të cilit ka qenë i pranishëm në seancë publike dhe ka shprehur se i ka dërguar pretendimet e tij nëpërmjet email-it të datës 6.2.2023 dhe me shkrim, sqaroi se, *“ka pasur probleme me sistemin, duke qenë se ishte ndryshuar kodi i llogarisë jo për faj të tij dhe kanë komunikuar me KQZ nëpërmjet email-it për të zgjidhur situatën. Sapo është zgjidhur problematika, kanë raportuar aktivitetin në fjalë.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

13. Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndergjegjësues/Informues”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023.

Komiteti Shqiptar i Birësimit, nëpërmjet email- it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se, *“vonesa ka ardhur si shkak i llogaritjes në mënyrë të gabuar të afatit 5 ditor. Kanë përfshirë në këtë afat edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoi se moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Komiteti Shqiptar i Birësimit ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e

krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

14. Kryeministria ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/kontroll”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Kryeministria, nëpërmjet email- it të datës 7.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“aktiviteti është zhvilluar nga FSHZH dhe Kryeministri në këtë aktivitet është në cilësinë e të ftuarit. Por duke qenë se morën dijeni që FSHZH nuk ka llogari të hapur në faqen e KQZ, vendosën të raportonin vetë për korrektësi por koha ishte e pamjaftueshme.”* .

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Kryeministria nuk ka patur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

15. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 7 (shtatë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
2. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
3. Aktivitet “Event përkujtimor per Holokaustin, nga Izraeli House Albania”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
4. Aktivitet “Inagurim”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
5. Aktivitet “Aktivitet ndërgjegjesues/informues”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
6. Aktivitet “Takim Diplomatik”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
7. Aktivitet “Takim Diplomatik”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, nëpërmjet email-it të datës 7.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij për secilin prej aktiviteteve duke pretenduar se,

- “Për shkak të situatës të rënduar të borës ministrja është nisur menjëherë në vendin e bllokuar dhe ka qenë i pamundur raportimi.
- Një aktivitet kemi pasur paqartësi nëse duhej të raportohej, për shkak se është zhvilluar jashtë orarit zyrtar të punës, për këtë arsye ka ardhur vonesa.
- Në një aktivitet ka qenë në cilësinë e të ftuarit dhe jo organizator.
- Një aktivitet pjesëmarrja është vendosur një ditë para se të zhvillohej dhe bëhet fjalë për promovim libri, jo inagurim.
- Një rast rast nuk rezulton në agjendën e ministres dhe konstatojmë se është gabim në raportim
- Në dy aktivitete pjesëmarrja është vendosur një ditë para se të zhvillohej aktiviteti.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet krijoi bindjen se, tematika e 5 prej aktiviteteve, “tryezë diskutimi”, “event përkujtimor”, “promovim libri”, “takim diplomatik” që janë raportuar jashtë afatit ligjor, për sa informacion jepet në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që kanë këto veprimtari.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për një prej aktiviteteve vlerëson se, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk ka patur mundësi të respektojë afatit ligjor për raportimin e aktivitetit, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për një prej aktiviteteve vlerëson se, në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo epidemisë/pandemisë, nuk zbatohen përcaktimet e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, për akte apo veprimtari të cilat synojnë marrjen e masave për përballimin e pasojave të këtyre fatkeqësive natyrore apo epidemisë/pandemisë.

16. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inagurim”, raportuar në datë 1.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nëpërmjet email-it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se, *“në këtë aktivitet ka qenë në cilin e të ftuarit dhe gjithashtu për veprimtarinë në fjalë ishte ndryshuar data e planifikimit të parë të saj. Sapo ishte përcaktuar ndryshimi i datës, kanë kryer raportimin në sistem. Gjithashtu përmendin edhe burimet njerëzore të kufizuara që ka ky institucion.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka qenë në pamundësi për të përmbushur afatin ligjor për të raportuar këtë aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

17. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktivitet “Prezantimi i Programit të Kodimit për të Rinjtë tek të rinjtë e Korces”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, nëpërmjet email-it dhe shkresës nr. 673 prot., datë 8.2.2023 ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar për secilin prej aktiviteteve se *“vonesa ka ardhur si shkak i llogaritjes në mënyrë të gabuar të afatit 5 ditor. Kanë përfshirë në këtë afat edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

18. Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023.

Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, nëpërmjet email-it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se, *“vonesat kanë ardhur për shkak se kanë qenë të angazhuar me detyrat administrative, megjithatë pretendojnë se aktivitetet nuk janë zhvilluar si pasojë e këtyre angazhimeve administrative.”*

Për një aktivitet, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, aktiviteti nuk është zhvilluar. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaritë nuk janë zhvilluar.

19. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 7 (shtatë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
2. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
3. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
4. Aktivitet “Konferencë”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.2.2023,
5. Aktivitet “Takim”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023,
6. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023,
7. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 2.2.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.2.2023.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet shkresës nr. 701 prot., datë 8.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“është bërë një gabim në llogaritjen e afateve të raportimit, duke përfshirë edhe datën e zhvillimit të aktivitetit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkaku që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

20. Ministria e Drejtësisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 9 (nëntë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Interviste televizive”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.1.2023,
2. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.1.2023,
3. Aktivitet “Prezantim”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
4. Aktivitet “Mbrëmje Gala”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
5. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.1.2023,
6. Aktivitet “Ceremoni”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
7. Aktivitet “Paraqitja e Projektligj “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
8. Aktivitet “Takim pune”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.1.2023,
9. Aktivitet “Inagurim”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.2.2023.

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet email- it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“shtatë prej aktiviteteve kanë qenë jashtë agjendës së aktiviteteve dhe nuk mund të raportoheshin më herët, një prej aktiviteteve ishte me dyer të mbyllura dhe nuk është bërë asnjë publikim, ndërsa për njërin prej aktiviteteve të raportuara me*

vonesë kërkojmë mirëkuptimin pasi nuk është bërë asnjë postim vetëm është share i faqes të Komisionit të ligjeve.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura krijoi bindjen se, për aktivitetet, “intervistë televizive”, “tryezë diskutimi”, “mbrëmje gala”, “ceremoni”, “inagurim”, “takim pune”, “paraqitje e projektligjit”, që janë raportuar jashtë afatit ligjor konstatohet se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që kanë këto veprimtari.

21. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
1. Aktivitet “Nënshkrim marrëveshje”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,
 2. Aktivitet “Inspektim/kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
 3. Aktivitet “Deklaratë për media”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.1.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkaku që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

Gjithashtu për një prej aktiviteteve është e dukshme lapsusi që është kryer në sistem me hedhjen e të dhënave, duke qenë se data e raportimit është 27.01.2023, ndërsa si datë zhvillimi është 04.01.2023. Në këto kushte duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ.

Për veprimtarinë e raportuar për nëshkrimin e një marrëveshjeje, konstatohet se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari.

22. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Komision Parlamentar”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,
2. Aktivitet “Inspektim/kontroll”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 2.2.2023,
3. Aktivitet “Seancë plenare”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 2.2.2023.

Ministria e Kulturës, nëpërmjet email-it të datës 9.2.2023 dhe shkresës nr. 711 prot., datë 8.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se *“në dy prej aktiviteteve ka qenë në cilësinë e të ftuarit, duke e pasur të pamundur të njoftonte më herët. Për aktivitetin “seancë plenare raporton vetë Kuvendi.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Ministria e Kulturës ka qenë në pamundësi për të respektuar afatin ligjor për raportimin e këtyre aktiviteteve, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për veprimtaritë e raportuar për pjesëmarrje në seancë plenare në Kuvend apo në Komision Parlamentar, konstatohet se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që kanë këto veprimtari.

23. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim/kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.1.2023,
2. Aktivitet “Inspektim/kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet email-it të datës 8.2.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“vonesa ka ardhur si shkak i angazhimeve*

të shumta të cilat kanë sjellë ndryshime në agjendën e ministres. Gjithashtu ata shprehen se të dyja aktivitetet janë ripublikuar dhe është shtyrë data e zhvillimit të tyre.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, aktivitetet nuk janë zhvilluar por janë ripublikuar për një datë tjetër brenda afatit ligjor. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk kryer.

24. Prefekti i Qarkut Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Analizë pune”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e tij, nëpërmjet shkresës nr. 140 prot., datë 7.2.2023, Prefekti i Qarkut Korçë ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se, *“përcaktimi i datës ishte interpretuar gabim nga ana jonë dhe në vazhdimësi është raportuar brenda afateve kohore që përcaktohen në dispozitat ligjore të sipërcituara”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se nisur nga tematika e veprimtarisë të raportuar, konstatohet se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që kanë këto veprimtari.

Gjithashtu, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike.

Konstatohet se Prefekti i Qarkut Korçë ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

25. Prefekti i Qarkut Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023.

Prefekti i Qarkut Lezhë, nëpërmjet email- it të datës 6.2.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se, *“veprimtaria ka të bëjë me analizën vjetore të institucionit dhe duke qenë se Ministria e Brendshme që do të merrte pjesë e kishte të pamundur prezencën e saj atë ditë, janë detyruar dhe kanë shtyrë datën e aktivitetit. Kjo ka ndikuar në mos raportimin në kohë të aktivitetit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatohet se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari.

26. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 7 (shtatë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndërgjegjësues/Informues”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
- Aktivitet “Takime për trajtimin e rastit të të miturit në bashkëpunim me PMF Durres”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Takim me përfaqësuesit e Caritas Albania me qëllim ndjekjen e ecurisë së kurseve profesionale”, raportuar në datë 24.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.1.2023,
- Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 26.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023,
- Aktivitet “Seminar i organizuar nga UNICEF, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të policisë, OPGJ-së dhe specialistëve të QPKMR-së.”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.1.2023,
- Aktivitet “Takim me oficerët e Policisë Durres mbi trajtimin e rastit të të miturit të ndjekur në bashkëpunim me QPKMR”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023,
- Aktivitet “Takim me përfaqësues të Caritas Albania dhe me të miturit që do të trajtohen nga ne pas daljes nga IM Kavaja”, raportuar në datë 30.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.2.2023.

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, përfaqësuesja e së cilës ka qenë e pranishme në seancë publike dhe ka deklaruar se kanë dërguar pretendimet nëpërmjet shkresës nr. 57 prot., datë 6.2.2023, ku ka sqaruar se, *“nga 7 takimet e realizuara nga QPKMR, 5 prej tyre janë takime të realizuara me qëllim ndjekjen e rasteve të të miturve që na janë referuar nga policia, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe nga Organizata Caritas Albania. Për shkak të natyrës të takimeve rutinë të cilat ecin në linjë e dinamikës të ecurisë së rastit që po trajtohet shpesh herë nga ana jonë është e vështirë planifikimi sipas këtij afati. Konkretisht për njërin prej aktiviteteve raportimi është bërë*

me vonesë pasi në atë datë jemi njohur nga Ministria e Drejtësisë me detyrimin për të raportuar për aktivitetet. Ndërsa për aktivitetin tjetër shprehen se takimi është organizuar nga UNICEF dhe institucioni ynë ka qenë pjesëmarrës duke mos patur përfshirje direkte.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se nisur nga tematika e veprimtarisë të raportuar e cila lidhet me të miturit dhe ka një natyrë sensitive, ka hasur në vështirësi të raportimit në kohë nga Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Për këtë arsye vlerëson se nga sa informacion i dhënë në ndërfaqe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që kanë këto veprimtari.

Gjithashtu, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, për ato aktivitete që kanë qenë në cilësinë e të ftuarit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka qenë në pamundësi për të raportuar për këto aktivitete, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19 pikat 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Pushimin e procedimin administrativ ndaj:

- a) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës,
- b) Autoritetit Portual Durrës,
- c) Bashkisë Dibër,
- ç) Bashkisë Elbasan,
- d) Bashkisë Finiq,
- dh) Bashkisë Kamëz,

Data: 10.2.2023 Nr: 54
Ora: 11:00



Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 24 janar - 2 shkurt 2023”

- e) Bashkisë Kavajë,
- ë) Bashkisë Kukës,
- f) Bashkisë Lushnjë,
- g) Bashkisë Prrenjas,
- gj) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor,
- h) Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
- i) Komitetit Shqiptar të Birësimeve,
- j) Kryeministrisë,
- k) Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
- l) Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
- ll) Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
- m) Ministrit të Shtetit për Standardet dhe Shërbimet,
- n) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- nj) Ministrisë së Drejtësisë,
- o) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,
- p) Ministrisë së Kulturës,
- q) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- r) Prefektit të Qarkut Korçë,
- rr) Prefektit të Qarkut Lezhë,
- s) Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

2. Pushimi administrativ për shkaqet e arsyetuara në këtë vendim është i vlefshëm për shkeljet e raportuara me vonesë deri në datën 2.2.2023.
3. Tërheqje vëmendje ndaj organeve publike që të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e përcaktimeve të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.
4. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI